

Në operacionin antidrogë të Policisë së Kosovës , u ndaluan 11 të dyshuar



14:04 Në operacionin antidrogë të Policisë së Kosovës , u ndaluan 11 të dyshuar 08:59 Aksion anti-drogë në pesë komuna, ka të arrestuar

14:04 Në operacionin antidrogë të Policisë së Kosovës , u ndaluan 11 të dyshuar

Policia e Kosovës ka njoftuar se sot e ka zhvilluar një operacion në lokacione të ndryshme që ndërlidhen me trafikim të armëve dhe kultivim të bimëve narkotike.

Operacioni është zhvilluar në rajonin e Mitrovicës dhe të Pejës ndërsa si rezultat janë shogëruar në stacion 11 të dyshuar, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Policia ka bërë të ditur se janë kontrolluar shtëpitë e të dyshuarve dhe objektet përcjellëse, ndërsa është gjetur edhe një plantacion i bimëve narkotike në një fushë të hapur.

Gjatë operacionit policor u sekuestruan shtatë armë (2 AK-47 dhe 5 revole), rreth 70 fishekë të kalibrave të ndryshëm, 92 bimë kanabisi (marihuanë), mbi 25 gramë kokainë, 5500 euro para të gatshme, 6 telefonë dhe dokumente relevante për rastin.

Gjashtë prej të dyshuarve janë dërguar në mbajtje.

“Pas procedurave të intervistimit me urdhër të prokurorit kompetentë 6 prej tyre janë dërguar në mbajtje, Policia e Kosovës do të vazhdojë përkushtimin e saj në realizimin e detyrave për parandalimin dhe luftimin e kimit si dhe identifikimin dhe arrestimin e personave kryes të veprave penale”, thuhet në raportin e Policisë.



08:59 Aksion anti-drogë në pesë komuna, ka të arrestuar

Prokuroria Themelore në Pejë ka konfirmuar se të mërkurën në mëngjes është zhvilluar një aksion anti-drogë në pesë komuna dhe deri tani ka të arrestuar.

Aksioni ka nisur herët në mëngjes në Pejë, Istog, Klinë, Skenderaj dhe Mitrovicë.

Aksioni lidhet me dyshimin për import e shitblerje të paautorizuar të armëve si dhe kultivim të bimëve narkotike.

“Prokuroria Themelore në Pejë, departamenti i krimeve të rënda është duke zhvilluar sot një aksion në 5 komunat e RKS, Pejë, Istog, Klinë, Skenderaj dhe Mitrovicë dhe janë duke u bastisur 13 lokacione ku njëkohësisht është siguruar edhe vendi i ngjarjes ku dyshohet se ka plantacion të kanabisit. Poashtu në disa lokacione janë sekuestruar edhe armë, para, telefona dhe elemente tjera të veprës penale”, ka thënë Shkodran Nikçi, zëdhënës i Prokurorisë Themelore në Pejë.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.



- Arrestohen dy persona në Gjilan, kapen me mbi 15 kg marihuanë
- Arrestohet një person, dyshohet se përfitoi kundërligjshëm subvencione prej dhjetëra e mijëra eurosh
- Zhduket shtetasi i Shqipërisë në bjeshkët e Dragashit
- Mungojnë dy avokatë, shtyhet gjykimi në rastin “Toka”
- Policia kërkon ndihmën e qytetarëve për kapjen e një të dyshuari për zjarrvënje
- Podujevë, mashtronte me mjaltë, ndalohet i dyshuari
- Babai raporton se dy vajzat e tij të mitura u sulmuan seksualisht, arrestohen tre persona
- Një person dyshohet se u vetëvra në Prizren me kallashnikov
- Arrestohen tre persona në Shtime për lëndim trupor
- Arrestohen dy vëllezër në Gjilan me dyshimin se dhunuan një të mitur muaj më parë
- Arrestohen dy persona, pasi iu gjetën mbi 18 kg substanca narkotike
- Një shtetas nga Maqedonia tentoi kontrabandimin e arit në pikëkalimin e Hanit të Elezit

KOMENTO: Ne çmojmë mendimin tuaj. Prandaj kemi rikthyer seksionin e komenteve. Më poshtë mund të komentoni këtë artikull. Klikoni për të shkuar direkt te komentimi.

#AKSION #ANTI-DROGE

TË FUNDIT



Arrestohen dy persona në Gjilan, kapen me mbi 15 kg marihuanë



Arrestohet një person, dyshohet se përfitoi kundërligjshëm subvencione prej dhjetëra e mijëra eurosh



Zhduket shtetasi i Shqipërisë në bjeshkët e Dragashit



Mungojnë dy avokatë, shtyhet gjykimi në rastin “Toka”



Policia kërkon ndihmën e qytetarëve për kapjen e një të dyshuari për zjarrvënje



Podujevë, mashtronte me mjaltë, ndalohet i dyshuari



Babai raporton se dy vajzat e tij të mitura u sulmuan seksualisht, arrestohen tre persona



Një person dyshohet se u vetëvra në Prizren me kallashnikov



Arrestohen tre persona në Shtime për lëndim trupor



Arrestohen dy vëllezër në Gjilan me dyshimin se dhunuan një të mitur muaj më parë



Arrestohen dy persona, pasi iu gjetën mbi 18 kg substanca narkotike



Një shtetas nga Maqedonia tentoi kontrabandimin e arit në pikëkalimin e Hanit të Elezit

